



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 145

Tiranë – E hënë, 10 gusht 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe	
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 668, datë 29.7.2015	Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë, me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe sipërmarrjes, si qiradhënëse, dhe shoqërisë “Muka”, sh.p.k, si qiramarrës, për pasurinë “Magazina nr. 145”, në ndërmarrjen e prodhimit të çeliqueve, Elbasan.....	10803
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 672, datë 29.7.2015	Për një ndryshim në vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”.....	10803
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 673, datë 29.7.2015	Për një ndryshim në vendimin nr. 217, datë 11.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 8.4.2014, për çështjen “Karagjozi dhe të tjerë kundër Shqipërisë” (për ankimet nr. 25408/06, 37419/06; 49121/06; 1504/07; 19772/07; 46685/07; 49411/07; 27242/08; 61912/08 dhe 15075/09), të ndryshuar”.....	10805
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 674, datë 29.7.2015	Për kalimin e sporteve pritëse për qytetarët të zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme në administrim të Qendrës së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara.....	10805
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 675, datë 29.7.2015	Për disa shtesa në vendimin nr. 375, datë 6.6.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, regjistrimin, mënyrën e funksionimit, të administrimit e të ndërveprimit dhe për sigurinë e sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ALBSReP)”.....	10806
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 676, datë 29.7.2015	Për disa shtesa në vendimin nr. 376, datë 6.6.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurën e lëshimit të dokumenteve nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”.....	10806
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 677, datë 29.7.2015	Për miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Poçem”....	10807

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 678, datë 29.7.2015	Për disa ndryshime në vendimin nr. 522, datë 30.6.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga shpronësimi për qëllim të ndërtimit, pronësisë, shfrytëzimit, mirëmbajtjes dhe transferimit në favor të shtetit, të projektit të një hidrocentrali të ri në Ashtë, në qarkun e Shkodrës”, të ndryshuar.....	10807
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 679, datë 29.7.2015	Për hapjen e institucionit arsimor privat parauniversitar “Albanian College, Tiranë”.....	10809
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 680, datë 29.7.2015	Për miratimin e projektit pilot “Për masat për nxitjen e të nxëniet, vijueshmërisë dhe përparimit të nxënësve romë dhe egjiptianë të shkollës 9-vjeçare “Naim Frashëri”, Korçë, për vitin shkollor 2015 – 2016”.....	10810
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 681, datë 29.7.2015	Për dhënien e bursave për nxënësit e shkollës së mesme profesionale “Peter Mahringer”, Shkodër, për vitin shkollor 2015 – 2016.....	10812
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 682, datë 29.7.2015	Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit...	10812
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 685, datë 29.7.2015	Për një shtesë dhe ndryshim në vendimin nr. 932, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2015”.....	10813
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 686, datë 29.7.2015	Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore.....	10816
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 687, datë 29.7.2015	Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve.....	10827
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 688, datë 29.7.2015	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 332, datë 12.3.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave të përgjithshme për ruajtjen dhe administrimin e informacionit hartografik, të përftuar nga fotografimi ajror, dixhital i territorit të Republikës së Shqipërisë”....	10835
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 689, datë 29.7.2015	Për një shtesë në vendimin nr. 1619, datë 2.7.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësisë të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”.....	10836
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 690, datë 29.7.2015	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 555, datë 18.6.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për hapjen e procedurës së pranimit në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil”.....	10836
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 692, datë 29.7.2015	Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i urave dhe rrugëve hyrëse të projektit të gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP).....	10837
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 693, datë 29.7.2015	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Qafë Thanë – Lin - Pogradec, loti II (shtesat)”.....	10848

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 694, datë 29.7.2015	Për disa ndryshime në vendimin nr. 230, datë 13.3.2015, të Këshillit të Ministrave,“Për trajtimin me pagesë të qirasë për disa familje që preken nga zbatimi i projektit “Unaza e madhe e Tiranës, segmenti “Komuna e Parisit - Rruga e Kavajës””	10850
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 696, datë 31.7.2015	Për tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2016 – 2018.....	10853



VENDIM

Nr. 668, datë 29.7.2015

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR
LIDHJEN E KONTRATËS SË QIRASË,
ME TARIFËN 1 EURO/KONTRATA,
NDËRMJET MINISTRISË SË
ZHVILLIMIT EKONOMIK,
TURIZMIT, TREGTISË DHE
SIPËRMARRJES, SI QIRADHËNËS, DHE
SHOQËRISË “MUKA”, SHPK, SI
QIRAMARRËS, PËR PASURINË
“MAGAZINA NR. 145”, NË
NDËRMARRJEN E PRODHIMIT TË
ÇELIQEVE, ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në vijim të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontratave të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë, me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si qiradhënës dhe shoqërisë “Muka”, sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë “Magazina nr. 145”, në Ndërmarrjen e Prodhimit të Çelikeve, Elbasan, me sipërfaqe të përgjithshme 5393.3 (pesë mijë e treqind e nëntëdhjetë e tre pikë tre) m², nga të cilat: sipërfaqe nën objekt, 2760.25 (dy mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë pikë njëzet e pesë) m² dhe sipërfaqe funksionale, 2633.05 (dy mijë e gjashtëqind e tridhjetë e tre pikë zero pesë) m².

2. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

VENDIM

Nr. 672, datë 29.7.2015

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 408, DATË 13.5.2015, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
RREGULLORES SË ZHVILLIMIT TË
TERRITORIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 107/2014, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tekstin e rregullores së zhvillimit të territorit, miratuar me vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, neni 45, “Dispozita kalimtare” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 45

Deri në miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor për territoret administrative të bashkive:

a) kërkesat për leje zhvillimi/ndërtimi do të merren në shqyrtim nga autoritetet përgjegjëse vetëm për zhvillime të propozuara në zona të territorit vendor, për të cilat janë miratuar dokumentet e planifikimit të territorit, sipas hartës bashkëlidhur, me përjashtim të zonave me rëndësi kombëtare të trashëgimisë kulturore dhe historike dhe brezit bregdetar, sipas vendimit nr. 1, datë 8.10.2013, të Këshillit Kombëtar të Territorit, në të cilat çdo ndërtim i ri do të jetë objekt shqyrtimi nga Këshilli Kombëtar i Territorit.

b) për të gjitha zonat e tjera, që nuk përfshihen në shkronjën “a”, të këtij neni, kërkesat për leje ndërtimi do të merren në shqyrtim nga autoritetet përgjegjëse vetëm sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara me vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit.


c) për objektet mbi 6 kate, sipas shkronjave “a” dhe “b”, të këtij neni, leja e ndërtimit jepet nga Këshilli Kombëtar i Territorit.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**



Harta me territoret vendore që kanë dokumenta planifikimi të miratuara





VENDIM

Nr. 673, datë 29.7.2015

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 217, DATË 11.3.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 8.4.2014, PËR ÇËSHTJEN “KARAGJOZI DHE TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË” (PËR ANKIMET NR. 25408/06, 37419/06; 49121/06; 1504/07; 19772/07; 46685/07; 49411/07; 27242/08; 61912/08 DHE 15075/09), TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 8/1, e vendimit nr. 217, datë 11.3.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, riformulohet, si më poshtë vijon:

“8/1. Efekti financiar, i parashikuar në paragrafin e dytë, të pikës 1, të këtij vendimi, në shumën 135 564 492 (njëqind e tridhjetë e pesë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e katërqind e nëntëdhjetë e dy) lekë, të përballohet nga fondi i kontingjencës.”.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

VENDIM

Nr. 674, datë 29.7.2015

PËR KALIMIN E SPORTELEVE PRITËSE PËR QYTETARËT TË ZYRAVE VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME NË ADMINISTRIM TË QENDRËS SË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sportelet pritëse për qytetarët (*front-office/FO*) të zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme kalojnë në administrimin e Qendrës së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA).

2. Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe ministri i Drejtësisë, me urdhër të përbashkët, përcaktojnë sportelet e shërbimit që do të kalojnë nga zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme në administrimin e Qendrës së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara.

3. Mënyra e shkëmbimit të informacionit midis sporteleve pritëse për qytetarët (FO) të zyrave mbështetëse përgjegjëse për përpunimin e të dhënave dhe finalizimin e shërbimeve publike (*back-office/BO*) si organ kompetent do të rregullohet me një marrëveshje të përbashkët ndërmjet ZQRPP-së dhe Qendrës së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara. Në këtë marrëveshje do të përcaktohen procedurat e kalimit të shërbimeve e të dokumentacionit, sigurisë, menaxhimit të aseteve të përbashkëta, si dhe çështje të tjera në bazë dhe për zbatim të këtij vendimi.



4. ZQRPP-ja dhe Qendra e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara, nëpërmjet Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), të kryejnë trajnimin e punonjësve për kuadrin ligjor të pasurive të paluajtshme.

5. Efektet financiare të mbulohen nga buxheti i ADISA-s.

6. Tarifat dhe taksat, që do të mblidhen nga Qendra e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara, të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe të kalojnë në llogarinë e ZVRPP-së.

7. Çështjet, që kanë të bëjnë me administrimin/pronësinë e aseteve që janë në përdorim të sporteve pritëse për qytetarët në ZVRPP, të rregullohen me marrëveshje të përbashkët ndërmjet ZQRPP-së dhe Qendrës së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara.

8. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Ministria e Financave, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Qendra e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 675, datë 29.7.2015

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 375, DATË 6.6.2012, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN, REGJISTRIMIN, MËNYRËN E FUNKSIONIMIT, TË ADMINISTRIMIT E TË NDËRVEPRIMIT DHE PËR SIGURINË E SISTEMIT TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME (ALBSReP)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 6, të vendimit nr. 375, datë 6.6.2012, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa:

1. Pas nënndarjes “ii”, të shkronjës “b”, shtohet nënndarja “iii”, me këtë përmbajtje:

“iii. Qendra e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara.”.

2. Pas nënndarjes “ii”, të shkronjës “c”, shtohet nënndarja “ii/1”, me këtë përmbajtje:

“ii/1) Qendra e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 676, datë 29.7.2015

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 376, DATË 6.6.2012, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PROCEDURËN E LËSHIMIT TË DOKUMENTEVE NGA ZYRAT E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, dhe të paragrafit të fundit, të nenit 23, të ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994, “Për noterinë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 376, datë 6.6.2012, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa:

1. Në titullin e vendimit dhe në fjalinë e dytë, të pikës 3, pas fjalëve “...zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme...” shtohen “...dhe nga Qendra e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara...”.

3. Në pikat 9 dhe 11, pas fjalëve “...Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme...” shtohen “...dhe nga Qendra e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara...”.

4. Në pikën 10, pas fjalëve “...punonjës i Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme...”



shtohen fjalët "...dhe të Qendrës së Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara...".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 677, datë 29.7.2015

**PËR MIRATIMIN E BONUSIT, NË
PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE
KONKURRUESE, QË I JEPET
SHOQËRISË PËR DHËNIEN ME
KONCESION TË HIDROCENTRALIT
"POÇEM"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7, të ligjit nr. 125/2013, datë 25.4.2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e bonusit prej 8 (tetë) % të pikëve, që i jepet shoqërisë "Çinar-San Hafriyat Nakliyat İnşaat Turizm Sanayi Ve Ticaret Limited Şirketi" për rezultatin teknik dhe financiar në procedurën përzgjedhëse konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit "Poçem".

2. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 678, datë 29.7.2015

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
NR. 522, DATË 30.6.2010, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, "PËR
SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA
SHPRONËSIMI PËR QËLLIM TË
NDËRTIMIT, PRONËSISË,
SHFRYTËZIMIT, MIRËMBAJTJES DHE
TRANSFERIMIT NË FAVOR TË
SHTETIT, TË PROJEKTIT TË NJË
HIDROCENTRALI TË RI NË ASHTË,
NË QARKUN E SHKODRËS", TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 522, datë 30.6.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi. Sipërfaqja e përgjithshme që shpronësohet është 87 948 (tetëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e dyzet e tetë) m² (truall, arë, pemëtores), vlerësuar me shumën e përgjithshme prej 58 723 477 (pesëdhjetë e tetë milionë e shtatëqind e njëzet e tre mijë e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekësh."

2. Pika 4 riformulohet, si më poshtë vijon:

"4. Fondi i kompensimit dhe të gjitha shpenzimet procedurale do të përballohen nga Energji Ashta, sh.p.k., si subjekti kërkues i këtij shpronësimi."

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



Shërbija e Italisë së shpronësimit sipas VKM Nr. 522, datë 30.6.2010 Për shpronësimin, për interes publik, të pronave të pasurive të paluajtshme, pronë private, që përfshijn nga shpronësimi për qëllim të ndërtimit, pranimi, shfrytëzimit, mirëmbajtjes dhe transferimit në favor të Shtetit të projektit të një hidrocentrali të ri në Ahtëll, në Qarkun e Shkodrës

Qarku: Shkodër

Komuna: Beshkë

Lloji i pasurisë që shpronësohet: Pjlli

Lloji i pasurisë që dëmtohet në shkak të ndërtimit: s'ka

Nr	Objekt	Shpronësim Definitiv										Shpronësim provizor				Vlera totale e kompensimit	Adresa e pronarit	Shënime
		Emri	Aktet	Mbështet	Lloji i Pasurisë	Z.K	Nr Pasurisë	Sip. e Pasurisë (m ²)	Sip shpronësim definitiv (m ²)	Çmimi taksim	Vlera e kompensimit (Lekë)	Lloji i kultures	Sasia e njëq	Vlera Likuidimit	Vlera e kompensimit (Lekë)			
1	Ahtëll HPP	Heqar	Tahir	Mald	Pjll	2238	832/1	10.000,00	10.000,00	402	4.020.000,00	-	-	-	0	4.020.000,00	Kosmaj	
		Nasuf	Tahir	Mald														
		Anis	Fajzi	Mald														
		Arjola	Fajzi	Kalaj (Mald)														
		Ermenah	Fajzi	Mald														
		Nedre	Tahir	Idrici (Mald)														
		Felxete	Tahir	Sulejmani (Mald)														
Shuma në m2								10.000	Shuma në Lekë				4.020.000					

Adresa e pronarit është shënuar vetëm si Fshat, pasi nuk egzistojnë adresa të sakta rrugësh.

Shërbija e Italisë së shpronësimit sipas VKM Nr. 522, datë 30.6.2010 Për shpronësimin, për interes publik, të pronave të pasurive të paluajtshme, pronë private, që përfshijn nga shpronësimi për qëllim të ndërtimit, pranimi, shfrytëzimit, mirëmbajtjes dhe transferimit në favor të Shtetit të projektit të një hidrocentrali të ri në Ahtëll, në Qarkun e Shkodrës

Qarku: Shkodër

Emri i komunes: Beshkë


Lloji i pasurisë që shpronësohet: Ate / Tullaj / Përmirësim

Lloji i pasurisë që dëmtohet në shkak të ndërtimit: asnjë / Pronë tjetër

Nr	Emri	Hëmb	Mbeshtet	Lloji i Pasurisë	Z.K	Nr Pasurisë	Sip. e Pasurisë (m ²)	Sip shpronësim definitiv (m ²)	Çmimi taksim	Vlera e kompensimit (Lekë)	Shpronësim provizor			Vlera totale e kompensimit	Adresa e pronarit	Shënime	
											Lloji i kultures	Sasia e njëq	Vlera e kompensimit (Lekë)				
1	HEC Ahtëll	Lasar	Gasper	Deja	Përmirësim	1486	307	190,00	10,00	398	19.390,00	-	-	-	0	19.390,00	Deja
2	HEC Ahtëll	Çesk	Gasper	Deja	Përmirësim	1486	32/15	1.500,00	225,95	399	369.454,05	-	-	-	0	369.454,05	Deja
3	HEC Ahtëll	Ejall	Norik	Deja	Ate	1486	52/6	3.300,00	2.118,93	399	845.852,07	-	-	-	0	845.852,07	Deja
4	HEC Ahtëll	Gjon	Zaf	Deja	Ate	1486	52/40	450,00	450,00	399	179.550,00	-	-	-	0	179.550,00	Deja
5	HEC Ahtëll	Lek	Zaf	Deja	Ate	1486	52/42	1.000,00	1.000,00	399	399.000,00	-	-	-	0	399.000,00	Deja
6	HEC Ahtëll	Ludovik	Gasper	Deja	Përmirësim	1486	52/14	2.100,00	980,25	399	391.119,75	-	-	-	0	391.119,75	Deja
10	HEC Ahtëll	Martin	Qerim	Deja	Ate	1486	52/17	500,00	451,04	399	179.954,96	-	-	-	0	179.954,96	Deja
11	HEC Ahtëll	Perrit	Muhamet	Behari	Përmirësim	1486	47/10	1.100,00	1.100,00	399	438.900,00	-	-	-	0	438.900,00	Deja
12	HEC Ahtëll	Zaim	Shaqir	Hoxhaj	Përmirësim Tullaj	1486	47/17	5.752,00	1.151,89	399	459.604,11	-	-	-	0	459.604,11	Deja
13	HEC Ahtëll	Sanja	Hysen	Bujari	Ate	2702	81/2	17.460,00	16.200,39	418	8.771.763,02	-	-	-	0	8.771.763,02	Mjedë
16	HEC Ahtëll	Gëge	Noc	Noc	Ate	3496	129/2	1.890,00	442,34	399	176.493,96	Handhi	400	400	160.000,00	480.493,96	Spahari
												Përmirësim	51	3000	153.000,00		
17	HEC Ahtëll	Mark	Noc	Noc	Përmirësim	3496	109/4	750,00	734,00	399	292.866,00	Handhi	300	400	120.000,00	463.866,00	Spahari
												Përmirësim	17	3000	51.000,00		
18	HEC Ahtëll	Gac	Lazer	Caka	Përmirësim Tullaj	3496	105/7	560,00	155,00	399	61.845,00	Handhi	300	400	120.000,00	247.845,00	Spahari
												Përmirësim	22	3000	66.000,00		
21	HEC Ahtëll	Jek	Lazer	Caka	Përmirësim	3496	131/1	420,00	420,00	399	167.580,00	Handhi	285	400	114.000,00	314.580,00	Spahari
												Përmirësim	11	3000	33.000,00		
22	HEC Ahtëll	Lazer	Gac	Caka	Tullaj	3496	135	520,00	520,00	399	207.480,00	-	-	-	0	207.480,00	Spahari
Shuma në m2								26.761	Shuma në Lekë				11.778.423				

Adresa e pronarit është shënuar vetëm si Fshat, pasi nuk egzistojnë adresa të sakta rrugësh.

Energji Ahtëll
(Administrim)





Shërbimi i Kadastrës së Shqipërisë sipas VPKM Nr. 522, datë 30.6.2014 Për shpronësimin, çfarë mëson publikisht, të pronarëve të pasurive të pasurisë shtetërore, pronë shtetërore, të pronarëve nga shpronësimi për qëllim të ndërtimit, rindërtimit, shtyrjesimit, rindërtimit dhe transferimit në favor të Shtetit të projektit të një hidrocentrali të ri në Kallitë, në Qarkun e Shkupit.

TABELA PËRMBLEDHËSE PËR QARKUN SHKUPIT

nr	Objekti	Njësia e Qeverisjes Vendore	Shpronësim Definitiv						Të mbijellat			Vlera totale e kompensimit	Shënime		
			Zona Kadastrale	Adresa	Lloji i pronës	Sipërfaqja e pronës (m2)	Sipërfaqja e shpronësimit (m2)	Çmimi Lekë/m2	Vlera e Kompensimit	Sipërfaqja	Lloji i të mbijellave			Vlera e të mbijellave	
1	HEC Ashta	Komuna Bushat	2238	Kosmaç	Pyll	10.000	10.000	402	4.020.000	0	-	0	4.020.000		
					Arë	5.250	4.021	399	1.604.367	0	-	0	1.604.367		
		1466	Dejë	Pemëtores	5.290	3.056	399	1.219.424	0	-	0	1.219.424			
				Truall	5.752	1.152	399	459.604	0	-	0	459.604			
		3498	Spatharë	Arë	1.690	442	399	176.494	0	-	0	176.494			
				Pemëtores	1.170	1.154	399	460.446	-	Hardhi Pemë frutore	817.000	1.277.446			
		2702	Mjedë	Truall	1.080	675	399	269.325	0	-	0	269.325			
				Arë	17.460	16.200	418	6.771.763	0	-	0	6.771.763			
								36.701		14.981.423			817.000	15.798.423	

Vlera totale e kompensimit 15.798.423 Lekë

VENDIM

Nr. 679, datë 29.7.2015

PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT ARSIMOR PRIVAT PARAUNIVERSITAR "ALBANIAN COLLEGE, TIRANË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 42, pika 5, të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie e lejes për hapjen e institucionit arsimor privat parauniversitar "Albanian College, Tiranë".

2. Institucioni arsimor privat parauniversitar "Albanian College, Tiranë" do të ushtrijë veprimtarinë arsimore në adresën Rruga e Kavajës, nr. 12, Tiranë.

3. Në institucionin arsimor privat parauniversitar "Albanian College, Tiranë" mësimi do të zhvillohet në gjuhën angleze. Në lëndët: Gjuha shqipe, Letërsia shqipe, Historia e kombit shqiptar dhe Gjeografia e Shqipërisë mësimi do të zhvillohet detyrimisht në gjuhën shqipe.

4. Institucioni arsimor privat parauniversitar "Albanian College, Tiranë" do të ofrojë arsimin parauniversitar në nivelet:

- arsim parashkollor;
- arsim bazë;
- arsim i mesëm i lartë (gjimnaz).

5. Forma e arsimit në institucionin arsimor privat parauniversitar "Albanian College, Tiranë" do të jetë arsimim me kohë të plotë.

6. Institucioni arsimor privat parauniversitar "Albanian College, Tiranë", me fillimin dhe gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, të raportojë në njësinë arsimore vendore përkatese, brenda afateve të përcaktuara, për:

a) numrin e fëmijëve të kopshtit, numrin e nxënësve dhe listën e mësuesve të arsimit bazë dhe arsimit të mesëm, të regjistruar në fillim dhe që do të mbarojnë vitin shkollor, sipas udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe statistikave të miratuara nga INSTAT-i;

b) planin mësimor, programet lëndore dhe strukturën që do të ketë institucioni në fillim të çdo viti shkollor;

c) aktin e regjistrimit në organin tatimor;

ç) listën e veprimtarive jashtëshkollore që janë parashikuar të zhvillohen gjatë vitit shkollor;

d) adresën e institucionit, adresën elektronike (e-mail) dhe numrin e telefonit.

7. Çdo ndryshim në planin mësimor, programet e lëndëve apo tekstet që do të përdorë, si edhe çdo projekt apo eksperimentim psikopedagogjik-didaktik, që kërkon të kryejë institucioni arsimor privat parauniversitar "Albanian College, Tiranë", miratohet nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, sipas rastit.

8. Ndryshimet që mund të pësojë institucioni arsimor privat parauniversitar i licencuar, në vendndodhjen dhe në infrastrukturën e godinës, shqyrtohen dhe miratohen nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, pas miratimit të njësisë arsimore



vendore, 3 (tre) muaj para fillimit të vitit shkollor përkatës.

9. Institucioni arsimor privat parauniversitar “Albanian College, Tiranë” duhet të ketë në ruajtje dokumentacionin e mëposhtëm:

a) dokumentacionin themeltar në ruajtje të përhershme, si: regjistër amze, indeks alfabetik, regjistër të veçantë, statistika vjetore të numrit të nxënësve dhe të mësuesve;

b) regjistra të përkohshëm, si: regjistra klase, evidencë për lëvizjen e nxënësve;

c) rregulloren e brendshme për funksionimin e institucionit;

ç) kriteret për pranimin e nxënësve dhe të mësuesve;

d) kontratat me prindërit për shërbimet arsimore apo shërbime të tjera jashtëshkollore që ofron;

dh) kontrata e punës me mësuesit (për ata me kohë të plotë apo të pjesshme).

10. Dokumentacioni i paraqitur në pikat 6 dhe 9, në rast monitorimi dhe inspektimi, u vihet në dispozicion organeve kompetente mbikëqyrëse.

11. Moszbatimi apo mosrespektimi i këtyre detyrimeve, si dhe mosdhënia apo fshehja e informacioneve ndaj organeve kompetente mbikëqyrëse dhe inspektuese, të cilat do të verifikojnë apo kontrollojnë funksionimin dhe mbarëvajtjen e këtyre institucioneve arsimore, përbën kundërvajtje administrative dhe sanksionohet sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

12. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Drejtoria Arsimore Rajonale e Qytetit të Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 680, datë 29.7.2015

PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT PILOT “PËR MASAT PËR NXITJEN E TË NXËNIT, VIJUESHMËRISË DHE PËRPARIMIT TË NXËNËSVE ROMË DHE EGJIPTIANË TË SHKOLLËS 9- VJEÇARE “NAIM FRASHËRI”, KORÇË, PËR VITIN SHKOLLOR 2015 – 2016”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, 19 e 28, të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 160/2014, datë 27.11.2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie nga Ministria e Arsimit dhe Sportit të 289 (dyqind e tetëdhjetë e nëntë) bursave/kuotave ushqimore për nxënësit romë dhe egjiptianë të shkollës 9-vjeçare “Naim Frashëri”, Korçë, për vitin shkollor 2015 - 2016.

2. Vlera e bursës/kuotës ushqimore ditore është 76 (shtatëdhjetë e gjashtë) lekë në ditë për nxënësit, për mbulimin e kostos ushqimore. Vlera e bursës/kuotës ushqimore që do t’u ofrohet nxënësve në mjediset e shkollës në formën e shërbimit ushqimor ditor të paketuar, për çdo nxënësit, për 170 ditë mësimore, jepet sipas pasqyrës nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Drejtoria Arsimore Rajonale Korçë, në fillim të vitit shkollor, duhet të dërgojë pranë njësisë bazë të qeverisjes vendore, Bashkisë Korçë, listën emërore të nxënësve romë dhe egjiptianë, përfitues të bursës/kuotës ushqimore, të detajuar nga klasa e parë deri në klasën e nëntë. Një kopje e listës emërore të nxënësve të trajtuar me bursë/kuotë ushqimore i dërgohet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

4. Fondet publike për mbulimin e shpenzimeve për bursat/kuotat ushqimore rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Sportit për Bashkinë Korçë dhe administrohen nga kjo bashki.



5. Drejtoria Arsimore Rajonale Korçë dhe drejtoria e shkollës “Naim Frashëri”, Korçë, organizojnë aktivitete ekstrakurrikulare, me qëllim nxitjen e të nxënësve, vijueshmërisë dhe përparimit të nxënësve romë dhe egjiptianë të shkollës “Naim Frashëri”, Korçë. Këto aktivitete organizohen në përputhje me udhëzimin nr. 21, datë 23.7.2010, të ministrit të Arsimit “Për normat e punës mësimore-edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në arsimin parauniversitar”, të ndryshuar.

6. Efektet financiare të mbulohen nga buxheti vjetor i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit në programin buxhetor të arsimit 9-vjeçar.

7. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave, Bashkia Korçë dhe Drejtoria Arsimore Rajonale Korçë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Pasqyra nr. 1
KUOTAT FINANCIARE SIPAS NORMAVE NË NATYRË PËR USHQIMIN E NXËNËSVE
(VITI MËSIMOR 2015-2016)

Nr.	Emërtimi	Njësia matëse	Norma ditore	Vlera energjetike (në kcal)	Çmimi mesatar/njësi	Vlera ditore/në lekë
1	Bukë	gram	120	341.95	100	12.0
2	Makarona	gram	10.5	37.45	120	1.3
3	Oriz	gram	10.5	38.15	150	1.6
4	Sheqer	gram	14	54.95	100	1.4
5	Fasule	gram	10.5	32.55	150	1.6
6	Perime	gram	45.5	9.45	100	4.6
7	Fruta	gram	35	14.7	100	3.5
8	Vaj	gram	10.5	94.5	180	1.9
9	Gjalpë	gram	7	53.2	531	3.7
10	Mish	gram	31.5	45.5	750	23.6
11	Djathë	gram	8.75	14	400	3.5
12	Reçel	gram	7	32.55	250	1.8
13	Vezë	kokërr	0.35	14.7	12	4.2
14	Qumësht	gram	70	34.3	80	5.6
15	Patate	gram	70	59.5	40	2.8
16	Nënprodukte pule dhe mishi	gram	10.5	35	400	3.2
	KUOTA DITORE			912.45		76

Shënim. Është e domosdoshme që nxënësi të marrë kuotën ditore në lekë dhe në kalori, ndërsa gramaturat dhe lloji i ushqimit mund të ndryshojnë sipas menyve të ndryshme dhe çmimeve që ofrohen nga konkurrenca e prokurimeve dhe ndikimit të faktorëve të tjerë (gramaturat e normës ditore në pasqyrë janë përdorur për efekt planifikimi).



VENDIM
Nr. 681, datë 29.7.2015

**PËR DHËNIEN E BURSIVE PËR
NXËNËSIT E SHKOLLËS SË MESME
PROFESIONALE “PETER
MAHRINGER”, SHKODËR, PËR VITIN
SHKOLLOR 2015 - 2016**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, 19 e 39, të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 9522, datë 25.4.2006, “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Austrisë, për bashkëpunimin në fushat e kulturës, të arsimit dhe shkencës”, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 160/2014, datë 27.11.2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie nga Ministria e Arsimit dhe Sportit të 84 (tetëdhjetë e katër) bursave të studimit për nxënës të shkollës së mesme profesionale “Peter Mahringer”, Shkodër, nga të cilat 24 (njëzet e katër) bursa studimi për nxënës të viteve përgatitore dhe 60 (gjashtëdhjetë) bursa studimi për nxënës të viteve të para, deri në vitin e katërt të shkollës së mesme profesionale “Peter Mahringer”, për vitin shkollor 2015 - 2016.

2. Vlera e bursës do të jetë 96 560 (nëntëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë) lekë për nxënës në vit, me qëllim shlyerjen e tarifës mujore të shkollimit dhe për mbulimin e kostos së teksteve mësimore. Vlera e masës së bursës do të paguhet pranë bankave të nivelit të dytë për çdo nxënës.

3. Fondi për mbulimin e këtyre bursave kalon nga Ministria e Arsimit dhe Sportit në Drejtorinë Arsimore Rajonale Shkodër.

4. Miratimi i këtyre bursave bëhet nga bordi i Fondacionit Shkollor Austriak, në mbështetje të kriterëve ekonomike e të rezultateve të arritura nga secili nxënës/aplikant.

5. Bordi i Fondacionit Shkollor Austriak, pas miratimit të bursave, dërgon dokumentacionin

përkatës në Drejtorinë Arsimore Rajonale Shkodër, e cila, pas konfirmimit të nxënësve që përfitojnë bursë, kalon masën e bursës në llogarinë personale të secilit nxënës.

6. Efektet financiare të mbulohen nga buxheti vjetor i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 682, datë 29.7.2015

**PËR PËRDORIMIN E FONDEVE
PUBLIKE PËR TRANSPORTIMIN E
PUNONJËSVE ARSIMORË QË
PUNOJNË DHE TË NXËNËSVE QË
MËSOJNË JASHTË VENDBANIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, neneve 5, 6, 19 dhe 28, të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të kreut II, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportin rrugor”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përballimin nga fondet publike të shpenzimeve për transportin e:

a) punonjësve arsimorë (drejtor, nëndrejtor, mësues) të institucioneve arsimore publike (shkolla publike të arsimit bazë, kopshte publike) të cilët punojnë jashtë qendrave urbane, qytetit/fshatit, në largësinë mbi 5 km nga kufiri i njësisë përbërëse administrative të vendbanimit të tyre të përhershëm, dhe kthehen brenda ditës;

b) nxënësve që ndjekin institucionet arsimore publike të arsimit bazë ose kopshtet publike, që udhëtojnë, nga vendbanimi i përhershëm në një vendbanim tjetër, mbi 2 km larg institucioneve arsimore publike më të afërta (shkollë/kopsht);



Në asnjë rast nuk përfitojnë shpenzime transporti nxënësit/fëmijët që udhëtojnë mbi 2 km, nëse në vendbanimin e tyre funksionojnë institucionet arsimore publike (shkollë/kopsht).

c) nxënësve që jetojnë në qendra rezidenciale të krijuara me vendim të Këshillit të Ministrave për grupe të nxënësve/fëmijëve/familjeve që vijnë nga shtresa sociale në nevojë dhe që udhëtojnë mbi 2 km larg për të ndjekur mësimin në institucionet arsimore publike më të afërta (shkollat e arsimit bazë ose kopshtet publike);

ç) nxënësve të arsimit parauniversitar me aftësi të kufizuara që gëzojnë statusin ligjor të invalidit, që nuk shikojnë, që nuk dëgjojnë, invalidit paraplegjik dhe invalidit tetraplegjik.

2. Njësitë arsimore vendore, mbështetur në numrin e mësuesve dhe nxënësve që planifikohen të përfitojnë nga shërbimi i transportit, në bashkëpunim me këshillat e qarqeve e njësitë bazë të qeverisjes vendore, miratojnë hartën e linjave, sipas largësive të përmendura në pikën 1, të këtij vendimi.

3. Njësitë arsimore vendore, mbështetur në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, prokurojnë fondet publike për shërbimin e transportit të nxënësve dhe punonjësve arsimorë, sipas linjave rrethqytetase të shërbimit të transportit publik, të licencuara në bazë qarku nga njësitë e qeverisjes vendore ose qendrore.

Në rastet kur njësitë arsimore vendore nuk realizojnë me sukses procedurat e prokurimit publik të shërbimit të transportit të punonjësve arsimorë dhe nxënësve, të parashikuar në pikën 3, të këtij vendimi, këto njësi realizojnë mbulimin e shpenzimeve për shërbimin e transportit të mësuesve dhe nxënësve përfitues drejtpërdrejt, nëpërmjet llogarive bankare, në bankat e nivelit të dytë ose pranë zyrave të Postës Shqiptare, sh.a., në përputhje me pikën 4, të këtij vendimi. Masa e shpenzimeve për llogaritjet në bazë të numrit të nxënësve dhe të mësuesve, numrit të ditëve mësimore, çmimit mesatar të biletës për linjat ndërqytetase apo rrethqytetase të shërbimit të transportit, të miratuara me vendimin nr. 146, datë 26.2.1998, të Këshillit të Ministrave, “Për ndryshimin e tarifave të transportit të udhëtarëve”, të ndryshuar, dhe të indeksimit të çmimeve të shërbimit të transportit, të botuara çdo vit nga INSTAT-i, si dhe në bazë të akteve

të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

Punonjësit arsimorë që përfitojnë transport të siguar nga njësitë arsimore vendore, të parashikuar në pikën 1, të këtij vendimi, bazuar në vendimin nr. 194, datë 22.4.1999, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës së pagës së punonjësve arsimorë në arsimin parauniversitar”, të ndryshuar:

a) nuk përfitojnë shpërblim mujor për largësi më pak se 10 km nga vendbanimi i tyre;

b) përfitojnë shpërblim 1 000 (një mijë) lekë në muaj, kur kjo largësi është nga 10 km deri në më pak se 20 km;

c) përfitojnë shpërblim 1 800 (një mijë e tetëqind) lekë në muaj, kur kjo largësi është mbi 20 km.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

7. Vendimi nr. 709, datë 5.10.2011, i Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e mësuesve dhe nxënësve që punojnë e mësojnë jashtë vendbanimit”, shfuqizohet.

8. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave, njësitë arsimore vendore dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 685, datë 29.7.2015

PËR NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 932, DATË 29.12.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR FINANCIMIN E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE SPITALORE NGA SKEMA E DETYRUESHME E SIGURIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR PËR VITIN 2015”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 160/2014, datë 27.11.2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, dhe të nenit 10, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në



Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 932, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Pas pikës 16 shtohet pika 16.1, me këtë përmbajtje:

“16.1 Për raste të veçanta të mungesës së mjekut specialist në shërbime të ndryshme të spitaleve rajonale e bashkiake, ministri i Shëndetësisë, brenda numrit të përgjithshëm të personelit spitalor, të parashikuar në shtojcën 2, bashkëlidhur këtij vendimi, urdhëron kontraktimin, për një periudhë të caktuar, të mjekëve specialistë, por jo më shumë se 200 mjekë në vit. Këta mjekë të specialiteteve të ndryshme, përveç pagës, trajtohen financiarisht me një bonus në masën 100 000 lekë në muaj. Ky bonus, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, trajtohet sipas shkronjës “e”, të pikës 2, të kreut II, të vendimit nr. 77, datë 28.1.2015, të Këshillit

të Ministrave, “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”.

Mjekët e kontraktuar sipas paragrafit të mësipërm nuk e përfitojnë shpërblimin sipas shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 9/1, të vendimit nr. 555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të punonjësve me arsim të lartë në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Spitalin Ushtarak Qendror Universitar, të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe për trajtimin e mjekëve në strukturat e Forcave të Armatosura”, të ndryshuar.”.

b) Shtojca 2, e vendimit nr. 932, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me shtojcën 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

Për të zhvilluar projektin (Titulli i projektit të propozuar, refero projektin në përputhje me aktivitet e listuara në shtojcat I dhe II të ligjit të VNM-së) me vendndodhje....., sipërfaqe....., koordinata.....

Bazuar në nenin 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar, i sugjerohet autoritetit planifikues: (Të zgjidhet një nga alternativat e mëposhtme:)

1. Miratimin e lejes së zhvillimit të atij projekti, pa asnjë vërejtje nga pikëpamja mjedisore;

2. Miratimin e lejes/licencës së zhvillimit të atij projekti, me kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis;

3. Refuzimin e kërkesës për leje/licencë zhvillimi për atë projekt, për shkak të ndikimeve të rëndësishme negative në mjedis me pasoja afatgjata, që dëmtojnë cilësinë e mjedisit dhe nuk mundësojnë përmbushjen e standardeve mjedisore përkatëse.

Bazuar në pikën 2, të nenit 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, më poshtë po listojmë:

1. Qëndrimin e ministrisë dhe, sipas rastit, kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi:

a).....

b).....

c).....

2. Konfirmimin se ministria ka marrë në shqyrtim mendimet e shprehura nga publiku dhe institucionet përkatëse, si dhe shkallën e reflektimit të tyre;

3. Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun;

4. Arsytet dhe konsideratat kryesore ku është mbështetur mendimi;

5. Përshkrimin, sipas rastit, të masave kryesore që duhen marrë për të shmangur, reduktuar e, nëse është e mundur, për të korrigjuar efektet negative të rëndësishme:

a).....

b).....

c).....

Drejtor i AKM-së
 (emri, firma, vula)

MINISTËR
 Emër, mbiemër
 (firma, vula)



VENDIM
Nr. 687, datë 29.7.2015

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE
PËR MBAJTJEN, PËRDITËSIMIN DHE
PUBLIKIMIN E STATISTIKAVE TË
MBETJEVE²**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 60, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve që lidhen me krijimin, riciklimin, rikuperimin, eksportin dhe asgjësimin e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Njësitë e qeverisjes vendore janë përgjegjëse për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim, sipas llojit, sasisë dhe përbërjes së tyre, të krijuara në territorin e njësisë së qeverisjes vendore që ato administrojnë.

3. Mbetjet e grumbulluara në mënyrë të diferencuar duhet të trajtohen referuar ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, me qëllim mbledhjen e përpunimit e të dhënave prej tyre.

4. Njësitë e qeverisjes vendore janë të detyruara të plotësojnë formatin e raportimit të statistikave vjetore të mbetjeve për mbetjet e krijuara në territorin e tyre, sipas shtojcës nr. 3, bashkëlidhur këtij vendimi, dhe këto të dhëna ia dërgojnë këshillit të qarkut përkatës, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën/transportin brenda datës 31 janar, të çdo viti.

5. Mbështetur në vendimin nr. 1189, datë 18.11.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit”, ministria përgjegjëse për bujqësinë, ministria përgjegjëse për infrastrukturën/transportin, ministria përgjegjëse për shëndetësinë dhe ministria përgjegjëse për industrinë janë të detyruara të plotësojnë formatin e raportimit të statistikave vjetore të mbetjeve, sipas shtojcës nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi, dhe t’ia dorëzojnë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit brenda datës 10 shkurt të çdo viti.

6. Agjencia Kombëtare e Mjedisit mbledh, mban dhe përditëson statistikat për mbetjet sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi, në bazë të të dhënave të grumbulluara referuar pikave 4 e 5, të këtij vendimi, të cilat ia raporton ministrisë, brenda datës 28 shkurt të çdo viti.

7. Ministria përgjegjëse për mjedisin, në bazë të të dhënave të ardhura nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, përgatit dhe publikon në variantin elektronik dhe në *website*-in e ministrisë raportin 3-vjeçar për statistikat e mbetjeve në territorin e Republikës së Shqipërisë, të cilin ia vë në dispozicion publikut.

8. Ngarkohen ministria përgjegjëse për mjedisin, ministria përgjegjëse për infrastrukturën / transportin, ministria përgjegjëse për shëndetësinë, ministria përgjegjëse për industrinë, ministria përgjegjëse për bujqësinë, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, këshillat e qarqeve dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet juridike nga data 1 janar 2019.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

²Ky vendim, është përafuar në mënyrë të pjesshme me rregulloren (KE) nr. 2150/2002 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 25 nëntor 2002, “Për statistikat e mbetjeve”; Nr. CELEX 32002R2150; Gazeta Zyrtare L 332, 09/12/2002, P.0001-0036.



SHTOJCA NR.1

FORMATI PËR RAPORTIMIN NGA AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT PËR MBETJET E KRIJUARA GJATË NJË
VITI NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Tabela nr.1

Tëdhënat e informacionit	Kodi I Katalogut Shqiptar	Tiranë	Durrës	Shkodër	Vlorë	Elbasan	Korçë	Fier	Gjirokastrë	Lezhë	Dibër	Berat	Kukës
Numri i banorëve													
Sasia e mbetjeve për person kg/vit													
Sasia e mbetjeve shtëpiake kg/ton vit	20												
Sasia e mbetjeve inerte ton/vit	17 09 04												
Sasia e mbetjeve farmaceutike spitalore kg/ton vit	07 05 13*												
Sasia e mbetjeve spitalore jo të rrezikshme kg/ton vit	07 05												
Sasia e mbetjeve spitalore të rrezikshme + dentare kg/ton vit	18 01 10												
Sasia e mbetjeve spitalore të rrezikshme + dentare kg/ton vit	07 01 02*												
Sasia e mbetjeve plastike kg/ton vit	15 01 02 17 02 03												
Sasia e mbetjeve të qelqit kg/ton vit	15 01 07 17 02 02												
Sasia e mbetjeve metalike kg/ton vit	15 01 04 17 04 07												
Sasia e mbetjeve të drurit ton/m ³	15 01 03 17 02 01												
Sasia e mbetjeve leër dhe karton kg/ton vit	03 03 08 15 01 01												
Sasia e mbetjeve të baterive të dala jashtë përdorimit kg/ton vit	16 06 16 06 01* 16 06 06*												
Sasia e mbetjeve të gomave të dala jashtë përdorimit kg/ton vit	16 01 03												
Numri i automjeteve të dala jashtë përdorimit	400400 00												
Sasia e mbetjeve të vajrave të përdorura kg/ton vit	12 01 06* 12 01 10*												



FORMATI I RAPORTIMIT NGA AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT PËR LLOJET DHE SASITË E MBETJEVE TË
RICIKLUARA NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËRGJATË NJË VITI

Tabela nr.2

Të dhënat e informacionit	Kodi i Katalogut Shqiptar të mbetjeve	Tiranë	Durrës	Shkodër	Vlorë	Elbasan	Korçë	Fier	Gjirokastrë	Lezhë	Dibër	Berat	Kukës
Sasia e mbetjeve të gomave të dala jashtë përdorimit të ricikluara kg./ton vit	16 01 03 40040000												
Sasia e mbetjeve plastike të ricikluara kg./ton vit	15 01 02 17 02 03												
Sasia e mbetjeve të qelqit të ricikluara kg./ton vit	15 01 07 17 02 02												
Sasia e mbetjeve metalike ricikluar kg./ton vit	15 01 04 17 04 07												
Sasia e mbetjeve të letrës dhe kartonit të ricikluara kg./ton vit	15 01 01 03 03 08												
Sasia e mbetjeve të produkteve të tekstilit të ricikluara kg./ton vit	04 15 09 04												
Sasia e mbetjeve të drurit të trajtuara	15 01 04 17 02 01												
Sasia e mbetjeve të vajrave izoluara dhe përcjellëse nxehtësie që përmbajnë PCB/PCT të ricikluara kg./ton vit	13 03 01*												



FORMATI I RAPORTIMIT NGA AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT PËR LLOJET DHE SASITË E MBETJEVE TË EKSPORTUARA NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Tabela nr.3

Të dhënat e informacionit	Kodi i Katalogut Shqiptar të mbetjeve	Sasia totale e mbetjeve të importuara ton./vit	Sasia totale e mbetjeve të eksportuara ton./vit
Mbetje plastike	15 01 02 17 02 03		
Mbetje qelqi	15 01 07 17 02 02		
Mbetje metalike	15 01 04 17 04 07		
Mbetje druri			
Mbetje e letrës dhe kartonit	15 01 01 03 03 08		
Mbetje të baterive të dala jashtë përdorimit	16 06		
Mbetjetë gomave të dala jashtë përdorimit	16 01 03 40040000		
Mbetje të produkteve të tekstit	04 15 09 04		
Mbetje të vajrave të përdorura kg/ton vit	12 01 06* 12 01 10*		
Mbetje vajrash izoluese dhe përcjellëse nxehtësie që përmbajnë PCB/PCT	13 03 01*		
Mbetje farmaceutike	07 05 13* 07 01 02*		
Mbetje nga plehrat kimike dhe pesticideve të skaduar nga përdorimi në bujqësi kg/ton vit	20 01 19*		
Mbetje elektrike dhe elektronike kg/ton vit	16 02 20 01 36		



SHTOJCA NR.2

**FORMATI PËR RAPORTIMIN E MBETJEVE NGA MINISTRIA PËRGJEGJËSE PËR TRANSPORTIN DHE
INFRASTRUKTURËN NË AGJENCINË KOMBËTARE TË MJEDISIT**

Tabela nr.1

Të dhënat e informacionit	Kodi i Katalogut Shqiptar	Tiranë	Durrës	Shkodër	Vlorë	Elbasan	Korçë	Fier	Gjirokastrë	Lezhë	Dibër	Berat	Kukës
Numri i banorëve													
Sasia e mbetjeve vepër person kg/vit													
Sasia e mbetjeve shtëpiake kg/ton vit	20												
Numri i automjeteve të dala jashtë përdomimit													
Sasia e mbetjeve inerte ton/vit	17 09 04												
Sasia e mbetjeve të depozituara në lëndfill ton/vit													
Sasia e mbetjeve të depozituara në incinerator ton/vit													

**FORMATI PËR RAPORTIMIN E MBETJEVE NGA MINISTRIA PËRGJEGJËSE PËR SHËNDETËSINË
NË AGJENCINË KOMBËTARE TË MJEDISIT**

Tabela nr.2

Të dhënat e informacionit	Kodi i Katalogut Shqiptar	Tiranë	Durrës	Shkodër	Vlorë	Elbasan	Korçë	Fier	Gjirokastrë	Lezhë	Dibër	Berat	Kukës
Sasia e mbetjeve spitalore jo të rrezikshme kg / ton /vit	07 05												
Sasia e mbetjeve spitalore të rrezikshme + dentarekg./ton vit	07 01 02*												
Sasia e mbetjeve farmaceutike kg/ton vit	07 05 13*												
Sasia e mbetjeve të depozituara në lëndfill ton/vit													
Sasia e mbetjeve të depozituara në incinerator ton/vit													



**FORMATI PËR RAPORTIMIN E MBETJEVE NGA MINISTRIA PËRGJEGJËSE PËR BUJQËSINË NË AGJENCINË
KOMBËTARE TË MJEDISIT**

Tabela nr.3

Të dhënat e informacionit	Kodi i Katalogut Shqiptar	Tiranë	Durrës	Shkodër	Vlorë	Elbasan	Korçë	Fier	Gjirokastrë	Lezhë	Dibër	Berat	Kukës
Sasia e mbetjeve nga plehtrat kimike dhe pesticidet e skaduar nga përdorimi në bujqësi. kg/ton vit	20 01 19*												
Sasia e mbetjeve nga produktet e kafshëve kg/ton vit	02 01 02												
Sasia e mbetjeve bimore dhe shtazore e pakompostuar	19 05 02												
Sasia e mbetjeve farmaceutike bujqësore kg/ton vit	16 05 08*												
Sasia e mbetjeve të depozituara në lëndfill ton/vit													
Sasia e mbetjeve të depozituara në incinerator ton/vit													

**FORMATI PËR RAPORTIMIN E MBETJEVE NGA MINISTRIA PËRGJEGJËSE PËR INDUSTRIJËN NË AGJENCINË
KOMBËTARE TË MJEDISIT**

Tabela nr.4

Të dhënat e informacionit	Kodi i Katalogut Shqiptar	Tiranë	Durrës	Shkodër	Vlorë	Elbasan	Korçë	Fier	Gjirokastrë	Lezhë	Dibër	Berat	Kukës
Sasia e mbetjeve të vajrave izoluesh dhe përcjellëse nxehtësie që përmbajnë PCB/PCT kg/ton /vit	13 03 01*												
Sasia e mbetjeve nga sektori i industrisë dhe minierat kg/ton vit	01												
Sasia e mbetjeve të depozituara në lëndfill ton/vit													
Sasia e mbetjeve të depozituara në incinerator ton/vit													



SHTOJCA NR.3

FORMATI PËR RAPORTIMIN E MBETJEVE NGA NJËSIA E PUSHTETIT VENDOR, QARKU _____

Të dhënat e informacionit	Kodi i Katalogut Shqiptar	Bashkia	Bashkia	Bashkia
Nurmi i banorëve				
Sasia e mbetjeve për person kg/vit				
Sasia e mbetjeve shëpiake kg/ ton vit	20			
Sasia e mbetjeve inerte kg/ ton vit	17 09 04			
Sasia e mbetjeve spitalore kg/ ton vit	18 01 10			
Sasia e mbetjeve plastike kg/ ton vit	17 02 03			
	15 01 02			
Sasia e mbetjeve të qelqit kg/ton vit	15 01 07			
Sasia e mbetjeve metalike kg/ ton vit	17 04 07			
	15 01 04			
Sasia e mbetjeve të drurit ton/m ³	17 02 01			
	15 01 03			
Sasia e mbetjeve të letërës dhe kartonit kg/ ton vit	15 01 01			
	03 03 08			
Sasia e mbetjeve të baterive të dala jashtë përdorimit kg/ton vit	16 06			
	16 06 01*			
	16 06 06*			
Sasia e mbetjeve të gomave të dala jashtë përdorimit kg/ton vit	16 01 03			
	400-400 00			
Sasia e mbetjeve të vajrave të përdorura kg/ton vit	12 01 06*			
	12 01 10*			
Sasia e mbetjeve nga produktet e kafshëve kg/ton vit	02 01 02			
Sasia e mbetjeve të produkteve të tekstilit kg/ ton vit	04			
	15 09 04			
Sasia e mbetjeve elektrike dhe elektronike kg/ton vit	16 02			
	20 01 36			
Sasia e mbetjeve të depozituara në lëndfill ton/vit				
Sasia e mbetjeve të depozituara në incinerator ton/vit				

**VENDIM**

Nr. 688, datë 29.7.2015

**PËR DISA SHTESA DHE
NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 332,
DATË 12.3.2008, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E
RREGULLAVE TË PËRGJITHSHME
PËR RUAJTJEN DHE ADMINISTRIMIN
E INFORMACIONIT HARTOGRAFIK,
TË PËRFTUAR NGA FOTOGRAFIMI
AJROR, DIXHITAL I TERRITORIT TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 20, të ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të pikës 3, të nenit 4, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban dhe ministrit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 332, datë 12.3.2008, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Pas pikës 2 shtohen pikat 2.1, 2.2, 2.3, 2.4, 2.5, 2.6 dhe 2.7, me këtë përmbajtje:

“2.1 Në funksion të sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ALUIZNI vendos në dispozicion të ZRPP-së hartën vektoriale të përditësuar me ndërtimet informale, sipas zonave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme (bllok kadastral).

2.2 Harta vektoriale e përditësuar vihet në dispozicion në format elektronik.

2.3 Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e administrimit të hartës vektoriale, ZRPP-ja informon ALUIZNI-n për gjendjen juridike të pasurive në bllokun kadastral përkatës. Për zonat kadastrale, që nuk i janë nënshtruar regjistrimit fillestar, ALUIZNI, me marrjen e informacionit nga ZRPP, kryen procedurat e njoftimit publik për 30 (tridhjetë) ditë, në një vend të përshtatshëm për konsultim publik.

2.4 ZRPP-ja përfundon, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga data e administrimit të hartës vektoriale, sipas rastit, procesin e korrigjimit

ose të përmirësimit/përditësimit të kartelave e të hartave kadastrale, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

2.5 Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, regjistrimi dhe transaksionet e pasurive të paluajtshme nga ZRPP-ja kryhen vetëm në format digjital, nëpërmjet sistemit elektronik (Albsrep). Në zbatim të kësaj pike, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZQRPP) duhet të hartojë dhe të miratojë një rregullore të posaçme.

2.6 ZQRPP-ja siguron shfaqjen e hartës kadastrale në Gjeoportalin Kombëtar të administruar nga ASIG-u, menjëherë nga momenti i regjistrimit apo transaksionit mbi pasurinë e paluajtshme.

2.7 Brenda datës 31 mars 2016, ZQRPP-ja duhet të hartojë projektin për digjitalizimin dhe përditësim/përmirësimin e të dhënave që posedon në format analog. Implementimi i projektit në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë realizohet brenda 3 (tri) viteve.”

b) Pas pikës 10 shtohen pikat 10.1 dhe 10.2, me këtë përmbajtje:

“10.1 ASIG-u, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, harton, në përputhje me pikën 1, të nenit 16, të ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor” “Standardin shtetëror” të informacionit gjeohapësinor për termat e parashikuar në shkronjat “e” dhe “f”, të nenit 11, të këtij ligji.

10.2 Produkti fotogrametrik (ortofoto), i përfutur nga fotografimi ajror digjital i territorit, përdoret deri në aplikimin e produktit të fotografimit të ri ajror.”

c) Pika 11 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“11. Prodhimi i informacionit gjeografik dhe i hartave topografike në shkallë të mëdha kryhet në përputhje me vendimin nr. 669, datë 7.8.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për përcaktimin, krijimin dhe realizimin e kornizës referuese, gjeodezike, shqiptare (KRGJSH-2010), si metadatë”.

ç) Kudo në tekstin e vendimit, emërtimi “Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit” zëvendësohet me “Ministria e Zhvillimit Urban”.

2. Ngarkohen ministri i Zhvillimit Urban, ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Adminis-



tratën Publike, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave / Ndërtimeve Informale dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 689, datë 29.7.2015

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 1619, DATË 2.7.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KLASIFIKIMIN E FUNKSIONEVE, GRUPIMIN E NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE PËR EFEKT PAGE DHE CAKTIMIN E KUFIJVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4/2, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të neneve 24, 32 e 54, të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 160/2014, datë 27.11.2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 13, të vendimit nr. 1619, datë 2.7.2008, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 13/1, me këtë përmbajtje:

“13/1 Struktura dhe kufijtë e pagave për administratorët e njësive administrative janë sipas lidhjes nr. 7, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara për njësitë e qeverisjes vendore për vitin 2015 dhe fillojnë nga data e fillimit të marrëdhënieve financiare të administratorëve, sipas akteve të emërimit të tyre në detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Kufijtë e pagave për administratorët e njësive administrative

Lidhja nr.7

1.	Për njësitë administrative me 20.001 – 50.000 banorë - Administratori: 51.500 – 92.500 lekë
2.	Për njësitë administrative me 5.001 – 20.000 banorë - Administratori: 41.400 – 79.500 lekë
3.	Për njësitë administrative me më pak se 5.000 banorë - Administratori: 37.400 – 56.100 lekë

VENDIM
Nr. 690, datë 29.7.2015

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 555, DATË 18.6.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË PRANIMIT NË KATEGORINË E ULËT DHE TË MESME DREJTUESE EDHE PËR KANDIDATË TË TJERË JASHTË SHËRBIMIT CIVIL”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në lidhjen nr. 1, të përmendur në pikën 3, të vendimit nr. 555, datë 18.6.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Numrat rendorë 4 dhe 10, në ndarjen I – “Niveli i mesëm drejtues dhe të barasvlershëm”, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“4. Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Juridike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës.

...

“10. Koordinator në Sekretariatit Teknik (Drejtorinë), sektori i qeverisjes së mirë dhe administrimit publik, në Kryeministri.”

2. Pas numrit rendor 38, në nëndarjen II - “Niveli i ulët drejtues dhe të barasvlershëm” shtohen pozicionet, si më poshtë vijon:



“39. Drejtor i Drejtorisë së Mbledhjes së Borxhit, në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Durrës.

40. Drejtor i Drejtorisë së Mbledhjes së Borxhit, në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Fier.

41. Drejtor i Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve, në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Elbasan.

42. Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Dibër.

43. Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Elbasan.

44. Drejtor i Drejtorisë së Mbledhjes së Borxhit, në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Elbasan.

45. Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Korçë.

46. Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Berat.

47. Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Lezhë.

48. Drejtor i Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve, në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Tiranë.

49. Drejtor i Drejtorisë së Mbledhjes së Borxhit, në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Tiranë.

50. Drejtor i Drejtorisë së Funkcioneve Mbështetëse, në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Tiranë.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 692, datë 29.7.2015

**PËR SHPRONËSIMIN DHE
MARRJEN NË PËRDORIM TË
PËRKOHSHËM, PËR INTERES PUBLIK,
TË PASURIVE TË PALUAJTSHME,
PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA
NDËRTIMI I URAVE DHE RRUGËVE
HYRËSE TË PROJEKTIT TË
GAZSJELLËSIT TRANS ADRIATIK
(PROJEKTI TAP)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 7 e 8, të pjesës së parë dhe të pjesës së dytë, të shtojcës 1, të marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë,

duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave dhe Trans Adriatic Pipeline AG, lidhur me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP), ratifikuar me ligjin nr. 116/2013, “Për ratifikimin e marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatic Pipeline AG”, dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i urave dhe rrugëve hyrëse, në zonat Korçë, Devoll dhe Skrapar, të projektit për ndërtimin e Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP), sipas tabelave 1, 2 dhe 3, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, me kërkesë të subjektit kërkues, shoqëria Trans Adriatic Pipeline (TAP AG).

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen dhe merren në përdorim të përkohshëm, të kompensohen në vlerë të plotë për sipërfaqen 30 057.8 (tridhjetë mijë e pesëdhjetë e shtatë pikë tetë) m², e cila shpronësohet, dhe për sipërfaqen 42 084.37 (dyzet e dy mijë e tetëdhjetë e katër pikë tridhjetë e shtatë) m², e cila merret në përdorim të përkohshëm, me një vlerë totale kompensimi prej 23 452 508.44 (njëzet e tre milionë e katërqind e pesëdhjetë e dy mijë e pesëqind e tetë pikë dyzet e katër) lekësh, e cila përfshin vlerën e shpronësimit, vlerën e marrjes në përdorim të përkohshëm, vlerën e kulturave bujqësore dhe vlerën e objekteve, sipas të dhënave të përcaktuara në tabelat 1, 2 dhe 3, bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Vlera totale e kompensimit dhe vlera e shpenzimeve procedurale të përballohen nga shoqëria TAP AG, si subjekti kërkues i këtij shpronësimi.

5. Për likuidimin, për efekt shpronësimi, dhe të marrjes në përdorim të përkohshëm të pasurive, të përcaktuara në tabelat 1, 2 dhe 3, të procedohet, si më poshtë vijon:



a) Për të gjitha pasuritë, për të cilat në tabelat bashkëlidhur është bërë shënimi “ZVRPP-ja konfirmon ndryshim midis sipërfaqes së dokumentit nga ajo fakt”, pronarët do të likuidohen pas saktësimit, pranë zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të sipërfaqes që kanë në pronësi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë që lëshohet nga kjo zyrë;

b) Për të gjitha pasuritë, për të cilat në tabelat bashkëlidhur është bërë shënimi “ZVRPP-ja konfirmon se për këtë pronë ka kufizim pasi mungon AMTP-ja”, pronarët do të likuidohen pas plotësimit të dokumentacionit të kërkuar nga zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë që lëshohet nga kjo zyrë;

c) Për të gjitha pasuritë, për të cilat në tabelat bashkëlidhur është bërë shënimi “ZVRPP-ja konfirmon se për këtë pronë ka kufizim”, pronarët do të likuidohen pas heqjes së kufizimit të vendosur mbi pronën, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë që lëshohet nga zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme;

ç) Për të gjitha pasuritë, për të cilat në tabelat bashkëlidhur është bërë shënimi “ZVRPP-ja konfirmon se mbi pronën është vendosur garanci kredie”, pronarët do të likuidohen pas heqjes së garancisë së vendosur, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë që lëshohet nga zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme;

d) Për të gjitha pasuritë, për të cilat në tabelat bashkëlidhur është bërë shënimi “ZVRPP-ja konfirmon se për këtë pronë ka kufizim pasi ka vendim sekuestro”, pronarët do të likuidohen pas heqjes së vendimit të sekuestros, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë që lëshohet nga zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme;

dh) Për të gjitha pasuritë, për të cilat në tabelat bashkëlidhur është bërë shënimi “ZVRPP-ja konfirmon se mbi pronën ka vendim të ndërmjetëm për sigurim padie”, pronarët do të likuidohen pas regjistrimit të vendimit të formës së prerë të gjykatës;

e) Për pasuritë, për të cilat në tabelat bashkëlidhur është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja se parcela është e pandarë”, pronarët do të likuidohen pas ndarjes dhe regjistrimit të secilës pasuri, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë që lëshohet nga zyra vendore e

regjistrimit të pasurive të paluajtshme;

ë) Për të gjitha pasuritë, për të cilat në tabelat bashkëlidhur është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, pronarët do të likuidohen në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë;

f) Për pasuritë, për të cilat vlera e përlogaritur e kompensimit rezulton më pak se 56 000 (pesëdhjetë e gjashtë mijë) lekë, TAP AG-ja kompenson pronarët me minimumin e kompensimit, prej 56 000 (pesëdhjetë e gjashtë mijë) lekësh, sipas tabelës 2, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij;

g) Për pasuritë me pronar shtet, të cilat rezultojnë me përdorues privat, TAP AG-ja kompenson përdoruesit privatë, sipas të dhënave të përcaktuara në tabelën 3, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

6. Çdo pronar, për t'u likuiduar për efekt shpronësimi dhe të marrjes në përdorim të përkohshëm, të dorëzojë pranë shoqërisë TAP AG dokumentacionin e plotë të pronësisë, vërtetimin bankar, lidhur me numrin e llogarisë dhe IBAN-in, si dhe kopjen e kartës së identitetit, të shoqëruar me një kërkesë.

7. Çdo përdorues të likuidohet, për efekt shpronësimi dhe të marrjes në përdorim të përkohshëm, në bazë të kopjes së dokumentit të identifikimit, vërtetimit bankar, lidhur me numrin e llogarisë dhe IBAN-in, si dhe certifikatës familjare, që dorëzon pranë shoqërisë TAP AG.

8. Procesi i shpronësimit të fillojë brenda muajit gusht 2015.

9. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme Korçë, Devoll dhe Skrapar të pezullojnë të gjitha transaksionet për pasuritë, sipas listave bashkëlidhur këtij vendimi, deri në momentin kur do të realizohen kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuar dhe regjistrimi i marrjes në përdorim të përkohshëm.

10. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme Korçë, Devoll dhe Skrapar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



LISTA 1
LISTA E PRONARËVE TË CILËT PËRKENËNGA RRUGËT HYRËSE

Nr.	Pronari	ZIK	Nr. Pas	Lloji Pas.	Sip. m ² për Marrjen e Përdorin të Përkohshëm Për 2 vjet.	Cmimi Lokëm?	Vlera Lokë	Sip. m ² Shpronësimit	Cmimi Lokëm?	Vlera Lokë	Vlera Totale e Kulturave	Objekte Vlera Lokë	Vlera në këtë për shpronësimin jetimë	Vlera Totale Lokë	Indeksi i Hartës	Shkëtime
1	Demir Namllari	13420	23110	Arë	989.00	52.50	51,922.50	1,026.00	210.00	215,460.00	24,180.00			231,642.50	K-34-125-(120-2)	ZVRRP konfirmim ndryshim më së dobetuarit nga ajo fakt dhe se për këtë pronë ka kufizim pasi: mungon AMTP Nr. 29
2	Petit Myrteza Namllari	13420	23132	Arë	414.52	52.50	21,762.30	341.31	210.00	71,675.10				93,437.40	K-34-125-(120-2)	ZVRRP konfirmim ndryshim më së dobetuarit nga ajo fakt
3	Behar Afet	13420	34112	Arë				135.51	210.00	28,457.10				28,457.10	K-34-125-(120-2)	Konfirmuar nga ZVRRP
4	Fiamir Sait	13420	4513	Arë	335.00	53.25	17,836.75	511.30	213.00	109,054.70		9,032.00		115,905.45	K-34-125-(120-2)	ZVRRP konfirmim ndryshim më së dobetuarit nga ajo fakt dhe se për këtë pronë ka kufizim pasi: mungon AMTP Nr. 20 (Objekti është mar.guri)
5	Fahir Demir	13420	9520	Arë	217.00	52.50	11,392.50	218.00	210.00	45,780.00	33,195.00			90,367.50	K-34-125-(102-C)	ZVRRP konfirmim ndryshim më së dobetuarit nga ajo fakt dhe se për këtë pronë ka kufizim pasi: mungon AMTP Nr. 78
6	Myrteza Shahtari	13420	9521	Arë	412.16	69.75	28,748.16	441.00	279.00	123,039.00	26,216.25	61,988.00		239,991.41	K-34-125-(102-C)	ZVRRP konfirmim ndryshim më së dobetuarit nga ajo fakt dhe se për këtë pronë ka kufizim pasi: mungon AMTP Nr. 71 (Objekti është mar.guri me ilaq)
7	Muharem Rea	13420	9522	Arë	255.92	55.75	14,267.54	233.31	223.00	52,028.13				66,295.67	K-34-125-(102-C)	ZVRRP konfirmim se për këtë pronë ka kufizim pasi: mungon AMTP Nr. 80
8	Hajri Rea	13420	9523	Arë	311.32	52.50	16,344.30	329.52	210.00	69,199.20	24,180.00			108,723.50	K-34-125-(102-C)	ZVRRP konfirmim ndryshim më së dobetuarit nga ajo fakt dhe se për këtë pronë ka kufizim pasi: mungon AMTP Nr. 39
9	Arifim Qamil	13420	9610	Arë	540.38	69.75	37,691.51	824.02	279.00	229,901.58	178,424.00	60,447.00		506,464.09	K-34-125-(102-C)	ZVRRP konfirmim ndryshim më së dobetuarit nga ajo fakt dhe se për këtë pronë ka kufizim pasi: mungon AMTP Nr. 39 (Objekti është mar.robatjet, mar.rrethet, pusete uji, cezmat)
10	Asmir Nasp	13420	9624	Arë	338.00	52.50	18,795.00	434.88	210.00	91,220.60	36,225.00			146,340.60	K-34-125-(102-C)	ZVRRP konfirmim se për këtë pronë ka kufizim pasi: mungon AMTP Nr. 29
11	Asqeni Qemal	13420	7715	Arë	395.00	69.75	27,351.25	216.00	279.00	60,364.00	9,214.80			87,815.25	K-34-125-(102-C)	Përdoren blloqet vetem për lotuarat
12	Asmir Moke	13420	12711	Arë	364.00	69.75	25,389.00	40.00	279.00	11,160.00	34,318.80			70,887.80	K-34-125-(102-C)	ZVRRP konfirmim ndryshim më së dobetuarit nga ajo fakt dhe se për këtë pronë ka kufizim pasi: mungon AMTP Nr. 45
13	Bido Sefedin	13420	7717	Arë	620.00	69.75	43,245.00	424.00	279.00	118,296.00	32,107.00			191,648.00	K-34-125-(102-C)	ZVRRP konfirmim se për këtë pronë ka kufizim pasi: mungon AMTP Nr. 72
14	Marsan Besim	13420	6211	Arë	598.00	52.50	31,395.00	545.00	210.00	114,450.00	11,960.00			157,805.00	K-34-125-(101-2)	ZVRRP konfirmim se për këtë pronë ka kufizim pasi: mungon AMTP Nr. 61
15	K.E. Sh.Fituli celbenik	19409	1311	Terra	15.38	52.50	807.45	12.00	210.00	2,520.00				463,338.00	K-34-125-(157-A)	ZVRRP konfirmim se për këtë pronë ndahet në veprime/Mungon VKM për ndryshimin e pronësisë (Objekti është Godinë)
16	Haisan Hahli	19409	4311	Arë							5,040.00			5,040.00	K-34-125-(141-2)	Hanan Hahli Hoxha është përdorues i cili blloqet vetem për lotuarat
17	Enver Smali	19409	2311	Arë	520.68	69.75	36,317.43	676.92	279.00	188,860.68				225,178.11	K-34-125-(141-2)	Konfirmuar nga ZVRRP
18	Bahri Smali	19409	2312	Arë	256.27	69.75	17,879.83		279.00	0.00				17,879.83	K-34-125-(141-2)	ZVRRP konfirmim ndryshim më së dobetuarit nga ajo fakt
19	Lebi Rrapo	19409	12916	Arë	366.74	69.75	25,389.12	279.00	210.00	25,333.63	45,226.00			96,339.75	K-34-125-(142-C)	Konfirmuar nga ZVRRP
20	Qemal Rrapo	19409	99	Arë	490.62	52.50	25,757.55	589.20	210.00	123,732.00				149,489.55	K-34-125-(142-C)	Konfirmuar nga ZVRRP
21	Bashkim Luleta	19409	12911	Arë	220.00	69.75	15,245.00	345.00	279.00	96,255.00		22,579.00		134,179.00	K-34-125-(142-C)	ZVRRP konfirmim ndryshim më së dobetuarit nga ajo fakt dhe se për këtë pronë ka kufizim pasi: mungon AMTP Nr. 88 (Objekti është mar.guri me ilaq)



22	Veli	Salo	Çeço	3017	67	Arë	238.00	52.50	12,495.00	19.00	210.00	3,990.00	90,236.40					ZVRPP konfirmim ndryshim midis siperfaqes së dokumentit nga ajo fakt
23	Veli	Salo	Çeço	3017	47	Arë	381.00	52.50	20,002.50	408.00	210.00	85,680.00	101,040.00					ZVRPP konfirmim ndryshim midis siperfaqes së dokumentit nga ajo fakt
24	Veli	Salo	Çeço	3017	74/12	Arë	134.95	52.50	7,084.88	144.00	210.00	30,240.00	153,227.40	45,138.00				ZVRPP konfirmim ndryshim midis siperfaqes së dokumentit nga ajo fakt (Objekti është mur euri)
25	Mëleq	Hasan	Çeço	3017	74/9	Arë + Trrall	36.00	52.50	1,890.00	53.00	210.00	11,130.00	56,540.00	27,095.00				ZVRPP konfirmim ndryshim midis siperfaqes së dokumentit nga ajo fakt/ (Objekti është mur guri i thatë)
26	Scalin	Teftik	Çeço	3017	74/10	Arë + Trrall	78.00	52.50	4,095.00		210.00							Konfirmuar nga ZVRPP
27	Schman	Haris	Çeço	3017	74/8	Arë + Trrall	73.89	52.50	3,879.23	89.58	210.00	18,811.80	79,027.00					Konfirmuar nga ZVRPP (Objekti është mur guri)
28	Vladimir	Mulamrem	Çeço	3017	14/14	Arë				76.00	210.00	15,960.00						Konfirmuar nga ZVRPP
29	Hals	Hajrin	Çeço	3017	14/15	Arë	310.18	52.50	16,284.45	220.00	210.00	46,200.00	27,837.60	34,998.00				Konfirmuar nga ZVRPP (Objekti është mur guri i thatë)
30	Mëleq	Hasan	Çeço	3017	14/12	Arë	466.00	52.50	24,465.00	355.00	210.00	74,550.00	286,689.10	16,934.00				ZVRPP konfirmim ndryshim midis siperfaqes së dokumentit nga ajo fakt/ (Objekti është mur guri i thatë)
31	Erver	Hasan	Çeço	3017	14/8	Arë	116.00	52.50	6,090.00	30.00	210.00	6,300.00	111,492.50					ZVRPP konfirmim ndryshim midis siperfaqes së dokumentit nga ajo fakt
32	Erver	Hasan	Çeço	3017	14/1	Arë	396.65	52.50	20,824.13	364.00	210.00	76,440.00						ZVRPP konfirmim ndryshim midis siperfaqes së dokumentit nga ajo fakt
33	Mulamrem	Barjam	Çeço	3017	74/22	Trrall				13.00	424.00	5,512.00	136.00	341,915.00				ZVRPP konfirmim ndryshim midis siperfaqes së dokumentit nga ajo fakt dhe sipërfaqes së dokumentit nga ajo fakt dhe sipërfaqes së dokumentit nga ajo fakt për katë prapë ka kufizim pasi mungon AMTP Nr.18 (Objekti është mur euri)
34	Hetem	Adem	Mustafaj	3017	20/10	Arë				2.00	210.00	420.00						Konfirmuar nga ZVRPP
35	Ali	Ejuni	Hasan	3037	31/65	Arë	196.62	69.75	13,714.25	199.31	279.00	55,607.49	13,345.20					Konfirmuar nga ZVRPP
36	Skender	Islan	Hasan	3037	31/618	Arë	208.42	69.75	14,537.30	422.47	279.00	117,864.13	58,706.00					ZVRPP konfirmim ndryshim midis siperfaqes së dokumentit nga ajo fakt / (Objekti është mur euri mbajtës)
37	Nazif	Erapo	Sibbo	3037	35/84	Arë	174.00	52.50	9,135.00	85.00	210.00	17,850.00	46,598.00					Konfirmuar nga ZVRPP
38	Shyqyri	Arif	Isufi	3037	30/65	Arë	280.08	52.50	14,704.20	282.00	210.00	59,220.00	19,824.00					ZVRPP konfirmim ndryshim midis siperfaqes së dokumentit nga ajo fakt
39	Luan	Ali	Hasan	3037	31/612	Arë	223.24	52.50	11,720.10	364.59	210.00	76,563.90	229,236.22	132,088.00				Konfirmuar nga ZVRPP (Objekti është mur euri mbajtës)
40	Ahri	Lame	Beho	3037	16/129	Arë	518.94	52.50	27,244.35	1,078.64	210.00	226,514.40	15,980.00					ZVRPP konfirmim ndryshim midis siperfaqes së dokumentit nga ajo fakt
41	Hasan	Bektrash	Beho	3037	16/113	Arë	548.00	52.50	28,770.00	1,067.09	210.00	224,088.90	47,642.50					ZVRPP konfirmim ndryshim midis siperfaqes së dokumentit nga ajo fakt dhe sipërfaqes së dokumentit nga ajo fakt për katë prapë ka kufizim pasi ka Vendim Shtetstro
42	Shyqyri	Arif	Isufi	3037	32/11	Arë	466.62	52.50	24,508.05	322.39	210.00	67,701.90	94,592.22					ZVRPP konfirmim ndryshim midis siperfaqes së dokumentit nga ajo fakt



43	Nedim	Ezaa	Isufi	3037	350/12	Arë	602.10	52.50	31,610.25	635.70	210.00	133,497.00	28,224.00				193,331.25	K-34-125-(141-A)	ZVRPP konfirmim ndryshim midis sipërfaqes së dokumentit nga ajo fakti / (Objekti është mur gurimballës)	
44	Seïman	Lame	Isufi	3037	356/12	Arë	993.00	52.50	59,132.50	1,308.80	210.00	274,848.00	46,524.00				373,504.50	K-34-125-(141-A)	ZVRPP konfirmim ndryshim midis sipërfaqes së dokumentit nga ajo fakti	
45	Berush	Nezhip	Eësa	3037	317/3	Arë	102.17	69.75	7,126.36	159.84	279.00	44,595.36	49,812.60				101,554.32	K-34-125-(141-A)	Konfirmuar nga ZVRPP	
46	Shyri	Avif	Isufi	3037	322/8	Arë	262.00	52.50	13,785.00	366.50	210.00	76,965.00	40,617.00				131,357.00	K-34-125-(141-A)	ZVRPP konfirmim ndryshim midis sipërfaqes së dokumentit nga ajo fakti	
47	Xhëvar	Nezhip	Eësa	3037	316/8	Arë	254.52	52.50	13,362.30	463.00	210.00	97,330.00	13,548.00				124,140.30	K-34-125-(141-A)	ZVRPP konfirmim ndryshim midis sipërfaqes së dokumentit nga ajo fakti / (Objekti është mur gurimballës)	
48	Gjenc	Adem	Hasjleri	3037	322/6	Arë	441.30	52.50	23,108.25		210.00	8,487.60					31,655.85	K-34-125-(141-A)	ZVRPP konfirmim ndryshim midis sipërfaqes së dokumentit nga ajo fakti	
49	Hekuran	Nezhip	Eësa	3037	264/11	Pendore	160.00	52.50	8,400.00	11.86	210.00	2,490.60	141,052.22	40,643.00				192,585.82	K-34-125-(141-A)	ZVRPP konfirmim ndryshim midis sipërfaqes së dokumentit nga ajo fakti / (Objekti është mur gurimballës)
50	Hekuran	Nezhip	Eësa	3037	44/2	Arë	108.21	52.50	5,681.03		210.00	65,665.20					71,346.23	K-34-125-(141-A)	Konfirmuar nga ZVRPP	
51	Drita Hamide	Mële	Eësa	3037	264/7	Arë	371.00	52.50	19,477.50	296.00	210.00	62,160.00	196,640.00				278,277.50	K-34-125-(141-A)	ZVRPP konfirmim ndryshim midis sipërfaqes së dokumentit nga ajo fakti dhe se për këtë pronë ka kufizim/ Bllokuar	
52	Nëbi Biko	Mële	Eësa	3037	190	Arë	456.98	52.50	23,991.45	80.00	210.00	16,800.00	42,560.20				83,351.63	K-34-125-(140-D)	Konfirmuar nga ZVRPP	
53	Erzë	Rambo	Levenishi	3037	200/3	Arë	466.00	52.50	24,465.00	7.00	210.00	1,470.00	65,670.02	11,290.00				102,895.02	K-34-125-(140-D)	ZVRPP konfirmim ndryshim midis sipërfaqes së dokumentit nga ajo fakti / (Objekti është mur gurimballës)
54	Muharrem	Nulke	Shahini	3037	174/11	Arë	186.79	52.50	9,806.48	268.01	210.00	56,282.10	10,260.00				76,348.58	K-34-125-(140-B)	ZVRPP konfirmim ndryshim midis sipërfaqes së dokumentit nga ajo fakti	
55	Hasan	Bekdash	Braho	3037	161/4	Arë	602.36	52.50	31,623.90	962.25	210.00	202,072.50	30,768.00				264,464.40	K-34-125-(140-B)	ZVRPP konfirmim ndryshim midis sipërfaqes së dokumentit nga ajo fakti dhe se për këtë pronë ka kufizim pasi ka Vendiin Sakuesiro	
56	Kadri	Islam	Shahinaj	3037	161/2	Arë						9,960.00					9,960.00	K-34-125-(140-B)	Kadri Islam: Shënim që është përdorues i cili banohet vetëm për kullurat	
57	Behar	Islam	Shahini	3037	161/1	Arë				515.00	210.00	108,150.00					108,150.00	K-34-125-(140-B)	Konfirmuar nga ZVRPP	
58	Luan	Aji	Eësa	3037	262	Arë	180.00	52.50	9,450.00	2.00	210.00	420.00					88,897.00	K-34-125-(141-A)	ZVRPP konfirmim ndryshim midis sipërfaqes së dokumentit nga ajo fakti / (Objekti është mur gurimballës)	
59	Behar	Islam	Shahini	3037	174/3	Arë	467.00	52.50	22,417.50	817.00	210.00	171,570.00					171,570.00	K-34-125-(140-B)	Konfirmuar nga ZVRPP	
60	Hasan	Bekdash	Braho	3037	161/10	Arë	228.00	53.25	12,141.00	590.00	210.00	123,900.00	24,408.00				170,725.50	K-34-125-(140-B)	Konfirmuar nga ZVRPP	
61	Lehte	Rambo	Braho	3037	374/3	Arë	228.00	53.25	12,141.00	244.00	213.00	51,972.00					64,113.00	K-34-125-(141-A)	ZVRPP konfirmim ndryshim midis sipërfaqes së dokumentit nga ajo fakti	
62	Alir	Borjan	Petau	3037	173/11	Arë				648.00	210.00	136,080.00					136,080.00	K-34-125-(140-B)	ZVRPP konfirmim ndryshim midis sipërfaqes së dokumentit nga ajo fakti	
63	Fitë	Lame	Isufi	3037	359	Arë				7.00	210.00	1,470.00					1,470.00	K-34-125-(141-A)	Konfirmuar nga ZVRPP	
64	Absh	Bido	Shahinaj	3037	730	Arë				9.00	210.00	1,890.00					1,890.00	K-34-125-(123-D)	Konfirmuar nga ZVRPP	
65	Petit	Bekdash	Rambo	3437	112/2	Arë	431.20	82.20	35,574.00		330.00	0.00					35,574.00	K-34-126-(98-B)	Konfirmuar nga ZVRPP	



LISTA E PRONABËRËVE QË PËRKËNEN NGA BRUGËT HYRËSE ME MINIMUMIN EKOMPENSIMIT

